

MATERIALE E DOKUMENTA

ALEKSANDËR XHUVANI

FJALË E SHPREHJE TË GJUHËS SHQIPE¹

VII

mâ ndf. 1. *s' durohej*—; *nuk po fle-?*; *ç'keni thanë—?* = rum. *ce-ati mai vorbit?* gjerm. *was habt ihr sonst noch miteinander gesprochen?*; *asht nxemë shum, sa nuk flitet — me te; pushoi — shiu*; 2. *s'guzojshin me folë shqip as n'oborr të shkollës, se — në shkollë mbrenda jo se jo.*

mackë-a ef. një copë hekuri që i vihet boshtit të qerres që të mos ta hajë rrota.

macarungë-a ef. shkopi ose topuzi me të cilin rrihet daullja, krhs. Gaz. 245 *maçarungë*; edhe FGJSH 285 *macukë* = topurre.

maç: *m'u bâ — në bark* = më mbeti në bark, po thuaje ma (kur nuk e gjen dot një gjë që thotë ai tjetri).

maçok-u em.: *rri ose mburret si -u në thekërit.*

madh (i,e)- e (e) mb. i shumtë në numër, në sasi të madhe: *shi i — ra sot; paska ranë borë e -e këtej; sa akull i — ka ngrimë sot; kishte fitue pare të -e; ka ardhë fik i — (fiq në sasi të madhe) në pazar; ishte baltë e -e = shumë baltë; mizë e — e ka dalë; njeri i — kishte ardhë = shumë njerëz (Malësi e Shk.) bagëti e — e kishte ardhë sot në pazar; ka ardhë rob i —; punëtor i — ka ardhë sot kahmos; Austrija ishte tue çue nieri të — në Bukovinë; kjo vlen të — e gjâ = vlen shumë; u bana nevrike e — e (shumë nevrike) unë me atë zjarr sonte qi s'mund ta ndiznit.*

madhe-ja (e) ef.: *baj të — n për një gjâ* = bëj shamatë për diçka: *bani të — n ajo, pse nuk i blenë edhe asaj një lojë.*

madhe (të) ndf. : *atëherë Halili t' — na i ka thirrë* (Vis. Komb. I 263); *Marash Pali t' — briti* = briti me zë të lartë, sa mundi; *t' — paska thirrë*; *t' — Muja iu ka ngërmue*; *sa t' — Muji paska qeshë* = sa shumë (Vis. Komb. I 264); *sa t' — gjoku ka hingllue* (ib. 266); *Krajli t' — paska qeshë* (ib. 230).

madhe (me të) ndf. shumë: *ka fitue me të —; po fiton me të —; kërkuj me të — = kërkuj me këmbëngulje; ap me të — = përpiqem shumë: dhashë me të — që ta baje atë punë, po nuk e mbarova dot.*

madhe-ja ef. gjysheja (Berat); edhe FGJSH 285

madhem fm. rritem, bëhem i madh, e madhe.

1) Përpunuar dhe bërë gati për botim nga prof. Mahir Domi dhe Qemal Haxhihasani.

madhet (me të) ndf.: *i jap me të* —; *ja dhashë me të* — = me gjithë fuqi; *fitoj me të* — = shumë; *e kërkoj një gjâ me të* — = duke ngulur këmbë shumë.

madhëroj fk. madhëroj, ngre lart; gjerm. lobe, preise; sh. edhe FGJSH 285.

madhëri-a ef.: — *e shpirtit* = të qenët e tij të madh, të pasurit ndjenja të larta, sh. *shpirtmadh* e *shpirtmadhësi*.

madhëroj fk. bëj më të madh : *shtohetë* (kombi) e *madhërohetë* (N.Fr.Mës. 29); FGJSH 285.

madhështohem fm. mbahem më të madh, mburrem (Buz), gr. *ἐπαίρομαι*; edhe *madhështohem*; edh te Pj. Bogdani (40) = it. *insuperbirsi*; sh. edhe FGJSH 285.

madhështoj fk. 1. e bëj më të madh; 2. Buz. = lat. *magnificare*, exaltare; **madhështoni** *ju gjithë popullë* (Buz., Rom. XV, 11) = nderoni atë gjithë popujtë (Krist. ib), *mbronie atë gjithë llaotë* (Gr. Argjirokastr. ib.) = gr. *επαινεσάτωσαν, δοξολογίετε*

madhështor-e mb. : — *e mendjenaltë* = që mbahet më të madh; sh. edhe FGJSH 285

madhoj fk. e bëj më të madh, e zmadhoj, gjerm. *ich vergrößere*; **madhohem** fm. = bëhem më i madh, *madhem*, 2. ngre lart, madhështoj. Sh. edhe FGJSH 286.

mafër-a ef. shami grarie; sh. Bashk. 246.

magallë-a lodër cicmici (Shalë e Shkodrës).

magjar-i em. druri i violinës, i lahutës, i çiftelisë etj. (Lumë); sh. edhe FGJSH 286.

magjarec-i em. hekuri i zjarrit, ku pështeten drutë (Lumë); edhe *magjar zjarri* FGJSH 286.

magjatore-ja, magjitore-ja, majtore-ja ef. gruaja që bën bukët, që punon në magje; sh. edhe *magjreshë*; FGJSH 286 ka *magjetore-ja*.

magje-ja ef. 1.: *kjo mbillet në vija ose në* — ; *duhet të mbjellim* — *me spinaq*; 2. orendi kuzine prej druri, ku gatuhet buka; sh. edhe FGJSH 286.

magjreshë-a ef. gruaja që gatuan bukët, sh. *magjatore, magjitore, majtore*; FGJSH 286 ka *magjreshë*.

maherthi ndf. atëhere; *m'at'her* (ë) + *thi* (Shpat).

mahi-a ef., shm. — trari që vihet në një cep të shtëpisë dhe pështetet te shulëzi, trerët që vihen nëpër qoshet e çatisë, janë me të gjatë se gërshtëzat; (Tir.) fjetet e trerëvet që vihen prej murit në kulm të shtëpisë; sh. edhe FGJSH 286.

mahis fk. pezmatoj, acaroj (një plagë, një çështje etj.) ; sh. edhe FGJSH 286; **mahitet** fm. pezmatohet, malcohet (plaga): *u mahit plaga; marrëveshja u mahit* = zu të prishet, u ashpërsua; *kush e dinte se puna do t'ishte* — *ur aqë?* = do të ishte e keqësuar aqë shumë.

mahitem fm. bëj shaka, qesh, tallem: *âsht kah mahitet* (Veri); FGJSH 286. te *mahis*.

mahitar-e mb. emf. shakaxhi; edhe *hokatar*.

mahnitem fm. 1. mbetem me gojëhapët: *pas këtyre ushtarët u mahnitnë fare*; 2. *mbretëri e Bizandinjet edh'e Persëvet rronin po ishin mahniturë e dobëtuarë* (N. Frash., Ist. Përgj. 59). Sh. edhe FGJSH 286 *mahnit*.

mahunë-a ef. bishtaja me kokrrat e saj: — *e fasules*, — *e bathës* (Veri).

mâj fk. *mana, mâ*, mënd, mand, i jap gji, e ve të pijë (për dhen): *e mani bariu keçin?* (Tiranë).

maj, mah fk. e bëj të majmë: e *maha patën* (Gjir.), e *majta patën* (Berat); e **kam mahur, e kam majtur; pula u majt** = u ngjall (Doz. 141); *pula u maj*; sh. edhe FGJSH 287.

majë-a ef. shm. -a 1. skaji, cepi i hollë i një sendi: -a e *thikës*; -a e *briskut*; -a e *gjylpanës*; -a e *gozhdës*; i *baj* — *kalemit* = e mpreh; pjesa e fundit e një sendi që vjen duke u holluar: -a e *hundës*, -at e *kambëvet*, -at e *gishtavet*, -a e *gjuhës*; *eci në* — *të gishtavet* (për mos me u ndie prej dikujt); 2. pjesa e sipërme a pjesa më e lartë e një trupi, e një druri, e një mali: — a e *kresë*; *hypi në* — *të kumbullës*; *dola në* — *të malit*; edhe *çukë*, *pingë*, *kikël*; 3. *të kam në* — *të kresë* = = të nderoj, të dua shumë; *ka qenë gjithë ditën në* — *të kambëvet* = në lëvizje, s'ka ndenjor; *u lodha gjithë ditën në* — *të kalit* = hipur në kal; *ka hypë majë gjogut*; e *kishte (akëcilin) në* — *të buzës* = e përmendte gjithnjë; e *ka përgjigjen në* — *të buzës* ose *në* — *të gjuhës* = e ka të gatshme, të shpejtë përgjigjen (thuhet për ndonjë që përgjigjet për çdo gjë; *për t'u justifikuar e kanë në* — *të gjuhës fjalën*; *ma ka sjellë shpirtin në* — *të hundës* = më ka mërzitë tepër; *po ha në* — *të buzës* = me zor e pak; 4. përdoret në shprehje të ndryshme për të treguar sasi të pakë: *një* — *luge* (miell, voj etj.) i *dhashë* = shumë pak; *asnjë* — *gjylpane nuk i mora* = s'i mora asgjë; 5. pjesa më e mirë, më e zgjedhur: — a e *miellit* = enda e miellit, pahu, pjalmi; 6. *ia mbledh* — n *mullarit të barit* (thuhet kur e mbledh e e ve mullar barin dhe si e mbaron, sipër ja mbledh majën); *fig.* e mbyll një punë. një proces pune, një bisedë; i *ap* — (ose *maje*) *një pune* = e mbaroj; *kësaj pune s'mun i jap maje* = s' di si ta spjegoj, s'mund t'i jap qish; *bindet njerka e s'din me i dhanë majë një pune*; *kujdesi e njerëzia ja ven* — n *punës* = e qit në krye, e mbaron (Bashk. 245); 7. *ajo shtëpi nuk bën dot* — = nuk vete përpara, nuk shkon mbarë (Vlorë); 8. *të gjitha me* — *të pares* = të gjitha me të paguar; 9. *baj* — = dukem, butthohem; 10. *ra* — *më krethi* = kokëngulmazi (kur rrëzohet dikush); 11. e *mbusha me* — = plot; — *më* — (lokuc ndf.): *ullijt sivjet janë* — *më* — = janë plot, kanë bërë shumë, kanë shumë kokrra në degë; 12. *erdhi* — *më* — = me vrap, me të shpejtë, gjerm. hoppeln; 13. *janë* — *më* — *kundrë njera jatrës* = pikërisht, tamam, gr. ἀκριβώς; 14. *flet* — *në* — = pa lidhje.

majë-a ef. të ushqyerit : *gja s'i mungonte kah* — a, *vesha*, *stolia*; sh. edhe FGJSH 287: të ushqyerit mirë: *prej* — s *së mirë*; emër postverbal nga folja *maj* < mbaj.

majkëzë-a ef. një copë shkop nja 20 cm. i gjatë për të pështjellë fiye leshti a pambuku, kur thurin rrobe n'avlëmend (Lushnjë); edhe *horëzë-a*.

majmë (i,e) mb. i ngjallur, i gjalltur: *dashi i* —, gr. *παχός*, sh. edhe FGJSH 287.

majmë-i (të) eas. : *qahet së majmi* = qahet kot, pa arësye, megjithëse i ka gjithë të mirat.

majmem fm. bëhem i majmë: *nuk i majmet trupi*; u *majma* (Kolonjë).

majmëtirë-a ef. të majmë-t: *të shoh ç'* — *kanë*.

majoke-ja ef. maja më e lartë e një peme (Jugë); krhs. *majole* = majë mali e vogël; FGJSH 286, Gaz. 347.

majsë-a, **mazë-a** ef. 1. ajka e qumështit; 2. cipa e hollë e qepës; sh. FGJSH 295 *mazë*.

majstroj fk. 1. gënjej, mashtroj: *mos gjindetë majshtruem* (Bogd. 60) 2. vjedh: *mos e majshtro gjan e huej*; *kush të gjindetë se ka vjedhunë e majshtruem gjan e huej* (id.)

majtur (i,e) mb. : *qafët e tyne rrathë rrathë të -a* (= të majura, të mahura) nga...

majth-i em. çekiç i vogël: *remi punohet me* — (Zemblak i Korçës); edhe FGJSH 287.

majungë-a ef. çekiç i madh, majth, majth i madh (Shkod.); sh. edhe Gaz 247, FGJSH 287 *majung-u*.

makalush-i mb. em. njeri i leshtë, syllesh; edhe *tatalesh-i* (Kosovë); edhe FGJSH 287.

makar se lidhz.: *të më zbulonjënë mkatnë*, — *t'ishte mâ i vogëli* = edhe sikur, edhe në se (Pj. Budi, Pasq. 10); krhs. *makar* FGJSH 287.

mak-mak psth. zëri, gërthitja e rosave: — *bâjnë rosat*.

makë-a ef., shm. -a 1. cipa e gjelbër që zënë përsipër ujërat e ndenjura, bimësia e gjelbër që krijohet në ujërat e ndenjura: *i mbituri kërkon të mbahet nga — at* (Gjirok.), krhs. me *makër*, *makërrë*, *makrosë*; 2. lëngu që lëshon delja që pjell; (Lumë), shtrati i pjellës së lopës, edhe *magë-a*; 3. këmishë e bardhë që veshin zakonisht gratë: *ka përvjelë -n deri n'brryl*; krhs. me *mangë*, ndofta ardhë prej saj; sh. edhe FGJSH 267.

makër-a shm. -a jargët që i bien deles kur piell; qyrrat që nxjerr lopa para se të pjellë; të bardhat; qyrrat që u dalin femëravet; sh. edhe *makërr-a* edhe FGJSH 287.

makërr(ë)-a ef., shm. -a qyrreja e kafshëvet me barrë, shenjë se gjiri femër është mbarsë: — *at i kullojnë penjë-penjë buacës, dhisë* etj. (Myzeqe); sh. edhe *makër*.

makloj fk. *maklue* përkëdhel, dhelatoj, mikloj, it. *accarezzare*.

maknore-ja ef. insekt këmbëshumë; edhe Gaz. 241 = kandër që jeton ndër shtëpija ku ka lagshtinë, i shpejtë në të ngam, etj.

makresë-a ef. gur i varrit, gr. *ἐπιτύμβιον* (Dibër)

makrosë-a ef. lëmashku, cipa e gjelbërt që zenë ujërat e ndenjura (Lumë); edhe FGJSH 288.

makrosët fm.: u **makros ujët** = ka vënë makrosë, është veshur me një cipë të gjelbër (Tiranë); edhe *makrohet* FGJSH (nga *makë* = makrosë).

makth-i em. shtrati i pjellës së bagëtisë (Lumë); edhe FGJSH 288.

makth-i em. këlysh lepuri; sh. edhe FGJSH 288.

makth-i ankthi, ajo që i çfaqet njeriut në ëndërr si një peshë e rëndë që i merr frymën e e pengon të ngrihet; sh. edhe FGJSH 288.

makth-i em. 1. një farë bime me erë që e trazojnë me preshët në lakror; 2. lule që mbin në male të larta, me të cilën barinjte bëjnë kurora, kur martohen; edhe FGJSH 288.

makut-i mb. em. 1. grykës; ai që ha çdo gjë; i pangopur, frgj. *glouton*, *avide de*, *insatiable*; gjerm. *gierig*; 2. i lig, gr. *κοιτοπόνηρος*; sh. edhe FGJSH 288.

makutëri-a ef. të qenët makut, vesi i makutit, frgj. *gloutonnerie*, *avidité*, *désir impétueux*.

malacak mb. : *fik* — = fik që nuk e rrit kokrrën, por e ka të ëmbël e prodhon shumë, krhs. *fik cingël*; FGJSH 288 = i malit.

malamal ndf. *lumi vinte* — = ishte plot me ujë, vinte breg më breg; edhe FGJSH 288.

malangu — **malangoi** em. lepuri, it. *lepore*, *coniglio* (G. Schiro, Raps. 220); krhs. me *langor-i*.

malcoj fk. fjk. pezmatoj (një plagë), e acaroj; *malcohem* fm.; u **malcue plaga** = umajis, u mahit, u mëri, u keqësua plaga, edhe FGJSH 288; fjk: *plaga e idhunë saa maa shpesh lëndonetë aqë ende maa tepërë malcon* (Pj. Budi, Pasq. 114).

malcuem (i), —e(e) mb. që është maisur, malcue; *fjalë t'idhuna e të malcuome* (Pj. Budi, Pasq. 42); *nd'i kaa fëjyem e e saa fjalë të nkota e të malcuome* (Pj. Budi, Pasq. 216)

malcueshëm (i), — e (e) mb. *mishi* — = që malcon, që maiset lehtë; *fjalë të këqia e të macuoshime* (Pj. Budi, Pasq. 2)

malë pf. majë: *ndë* — *të kuvendësë arrii edhe dhëlpëra: londari u egërsua mbi* — *dhëlpërësë* (Meyer, Alb. Stud. V 22); *londari u derth mbi* — *gomarit* ib. 26).

malhitem fm. 1. **malhitet** *mishi* = zë e prishet; **malhitet** *gjella* = thartohet; 2. **janë malhitë ata** = janë prishur shoq me shoq; **u malhitën burrat** = u zëmëruan, u inatosën (Elb.)

mal-i em. shm. — e 1. *erë -i*; *ujë -i* = ujë i ftohtë; *burrë -i* = burrë i fortë; *kambëz -i a -esh*; *thembër -i* = frgj. contrefort = varg i dytë malesh që ngjan sikur mbështet një varg kryesor; *faqe -i a shpat -i* = frgj. *versant*, gjerm. *abdachung*, *abhang*; *mishi në* —, *helli në zjarr*; *të rrojë sa malet* = të rrojë shumë; 2. shumë, me të madhet : *prandaj doje unë me -et*; *luftova me -et për atë punë*; *shtohet fjala e bahet* — ; *m'u sëmur dora e m'u ba* — = m'u enjt shumë; *më bahet zemra* — *nga gëzimi* = gëzohem shumë; *nxuar nga duartë gjith atë* — *punë* = atë punë të madhe (si sasi); *e kam* —, *e kam parë* — *atë punë* = shumë të vështirë.

malijë-a ef. erë mali (H. Pedersen. Alb. Texte); FGJSH 288 = veriu, era e veriut; *murrë-ri*.

malinë-a ef.: *të hangërt -a* (e sharë grash), edhe *malinkore-ja* (Him.).

malishe-ja et. pemë e madhe sa pjeshka, lulet i ka si lejla, me gjethe me erë si limoni, që i mbajnë në dorë për erë (Kavajë).

malishtë-a et. vend malesh, dhera në mal; edhe FGJSH 288.

malor-e mb. që ka të bëjë me malin, që është në mal: *rrugë -e*, *kullotë -e*, edhe FGJSH 288.

malsiak. mb. emf. malësor, Gaz. 493: njeri malësie, malsuer.

mall-i em. dëshirë: *kush ka* — *t'i çoj atij...* = nuk ka dëshirë, nuk ka ndërmend ndonjë t'i dërgojë atij; *s'kam* — (= nuk dua, nuk dëshiroj) *të vete atje*; *më kap -i të...* = më vjen dëshira të..., kam dëshirë të...; *na i ha -i me shkue* = = i ka zënë dëshira për të shkuar, *të na dali -i* = dhëmshuria për diçka të largët a që s'e kemi parë prej kohësh; dhëmshuri, dashuri; *s'kam* — *për tyj* = nuk të dua, s'kam dashuri për tyj; *s'dua të di për tyj*; *kush ka* — *për atë?*; *më zu -i për...*, *më ra -i për...*, *më mori -i për shtëpi* = frgj. *regretter la maison paternelle*; *na i ka ra* — *i shtëpisë*; *nuk më ha -i për...* = nuk kam gajle për..., gr. *δεν με μέλλει* *nuk e ha -i për të drejtën e të vërtetën* (J. Vreto, Mirëv. 153); *i kishte këcye -i i fortë për prind e për atdhe*; *të nxjerrësh -in* = merakun, të shmallesh; *me nxjerr* — *in e* (akëcilil ose akëcilës gjá) = më kujton atë njeri ose atë gjë nga përgjasimi që ka me të; *më çoi -in* = më nxorri mallin; *sa për* — = sa për qejf; *për* — = për merak; *djalë për* — (Kristof.) = i vetëm, gr. *μονογενής*.

mallangar -e mb. emf. dinak: *ç'* — *njeri është Liftua, s'e gënjen kurrë njeri* (Myzeqe. A. Dani).

mallesë-a ef. kullotë; edhe FGJSH 288; Gaz. 252 *mballesë* = vend ku mundën me mballue (= m'u endë tue kullotë) bagtia; kullosë: *njaj mal ka mballesë të mirë*; krhs. edhe Gaz. *mballue* = merr ballin bagëtia duke kullotur, përhapet duke kullotur; kullot, edhe *mballesë* = vend ku mund të mballojnë bagëtia; kullosë; edhe *mballim* = vend i hapët për gjënë e gjallë.

mallëkuos em. mallëkues, që mallkon (Bud. Pasq. 77).

mallëngjej fk.: *po mallëngjen flokët* = po qan flokët, i u dhims shumë se ja prenë flokët.

mallëngjim-i em.: — *i math të vinte, ke shifje misrat që ishin bâ ashtu* = të

dhimsej shumë, prekeshe; *kur e shof më vjen* — = *prekem*; *bante* — *macja për njerëzit*.

mallëngjyem (i) -e (e) mb.: *i — për fëmij* = *i malluar, i dëshiruem për fëmij, i do fort fëmijtë se nuk ka vetë*; em.: *ngushullon të nevojshmitë e të mallëngjyemitë* = *ata që janë të mallëngjyem, që mallëngjehen për dishka* (Pj. Budi, Pasq. 266), frëngj. *qui sont privés de —, it. indigente*.

mallëngjyeshëm ndf.: *qante* — = *me mallëngjim*; FGJSH 289.

mallëzohem fm. kam mallë, më ze malli, mallohem: *asht mallzue të shofi fëmij* = *e ka kapë malli të shohë fëmijë, ka shumë kohë që s'ka parë fëmijë*; **u mallzue fëmija për babën** = *u mallëngjye për babën*; **u mallëzuem për një kokërr mollë** = *na ka zënë malli për një kokërr mollë, kemi kohë që s'kemi ngrënë mollë*; sh. edhe *mallohem*.

mallohem fm. kam mall, më ze malli: — *për një gjë* (Jugë); *malloheshin fëmija për një pikë dhallë* = *ishin të djegur për dhallë, s'kishin dhallë*; sh. edhe *mallëzohem*.

malluar (i,e) mb.: *fliste i — për vendin e vet* = *plot mall*.

mallzoj fk. e fjk. prek, mallëngjej: *nji vajtoe ka qa, ka mallzue gur e dru* = *ka bërë që t'i vijë keq gjithkuj*; *mallzoi shtëpin e vet dhe gjithë vendin*; *bilbili këndon e mallzon* (Veri); sh. *mallëzohem*.

mameshë-a ef. *mamia* (Korçë).

manak-u em. një farë gjalmi i hollë që lidhet ditën e pranverës në duartë a në gushën e fëmijëve (mos është fjalë sllave?)

manat ndf. vetëm (= i vetëm): *po shkon — për Gramsh*; krhs. gr. *μόνος*, dhe *filli manakat*.

mand fk. mënd, i jap gji foshnjës, llaj.

mandar-i em. qingj i vogël; edhe *mandës-i*

mandatë-a ef. lajm i hidhur (i vdekjes) = *i erdhi — a e burrit*; *i dhanë — n* = *një lajmë të keq* (Gjirok.).

mandës-i em. qingj i vogël; nga *mand* (= mënd) = *i jap sisë*.

mandravidhë-a ef. vegla që shtrëngon torkun e mullirit; nga ital. *mandravite*.

manishtë-a ef. një farë bari me erë të mirë, frëngj. *menthe sauvage*.

mangëz-i em. shalësi, kopani që rreh lirin; edhe *mangën-a, mëngër-a* FGJSH 290 e 309; krhs. greq. *μάγγανος*

mangore-ja ef. mëngore, një e veshur prej leshi e shkurtër me mëngë, që më të shumtën e lënë pa e veshur; edhe FGJSH 290 dhe 209 *mangore e mëngore*.

manule-ja, mumule-ja ef. misri (shqipt. e Ukrainës).

manun-i qingj pirës, pijës (Berat, «Eduk. Re» III, 32), krhs *mënd*.

manxafë-a ef. shm. -a sobë, koftor.

manjë-a ef. një farë vese e trashë si mjaltë, që thuhej se binte më tepër në pranverë e që e mblihdnin barijtë nga fletët e bimëvet me një kupë.

maqorr-i em. maçok, dac (Veri)

maramenthi em. ndf. : *u çue* — (thuhet për një të dehur a të sëmurë kur ngrihet më këmbë e ze të ecë); em. i palakueshëm: *më vjen — kur hypi shkallët* = *më mirren mëntë*; edhe FGJSH 292 *marramenthi*.

maraq-i em. bimë që rritet deri në një metër lart dhe ka gjethe si të koprës, lëshon dega si purteka të holla; edhe *mërajë-a*; sh. FGJSH 290 *maraj-i* dhe *maraq-i*

marsh-i em. një farë parje e vjetër turke e hollë prej bakri (Kosovë); edhe *marjash-i* (Elbas.)

marazohem fm. marr maraz, inatosem, = frëngj. *s'indigner*; formuar nga emri *maraz* (turq., edhe greq. *μαράζ.*)

marcape-ja dhia që do të pjellë atë vit së pari (nga: *marr+cap*).

marcel-i em. flori i rremë që u varej në qafë fëmijëve (Gjir.); krhs. Gaz. 260 *mercel-i*: 1. stringël, lajle metali; 2. pare e imë (Malësi e Madhe e Shkodrës); *marcelë-a* (Dibër) = vathë që vihen në veshë, paret me të cilat stolisen gratë (?)

mardashë-a ef. delja që do të pjellë atë vit së pari; krhs. me *marcape-ja*.

mardhë-a ef. të ftohtë, të ftohtë i madh: *i hangri -a të lashtat* (Shpat i Elbas.); *pse ban ashtu, sikur ka ranë -a përjashta* (i thuhet ndonjerit, kur s'bën ftohtë); nga folja *mardh* = ngrij, mërdhif, mërdhij.

mareshtë-a ef. rrjetë peshqish (Mokër e Porad.) ; mos vjen nga *mrezhë?*

marí-a ef. 1. dele plakë; 2. grua plakë (Veri).

marishte-ja ef. druja që bën koçimare (Him.), sh. edhe fjal. e Leottit 649 *mareshtë*, ndërsa FGJSH 291 *mareshtë* = vend me marë.

markosh-e mb. i trashë shumë nga trupi që mezi luan vendit.

marise efs. verore, lidhka prej penjesh me ngjyra të ndryshme që i venin fëmijët ditën e verës, në mars, në qafat e duarve dhe në gushë (Gjir.)

martoj fk.: — *fiqt* = var nëpër dega të një fiku vargje me fiq të egër; miza e tyre hyn nëpër kokrrat e fiqvet të butë dhe nuk i le që të bien; edhe FGJSH 292.

marr fk. 1. kap, zë; — *nji bar* = e pij; *e merr pushka* = e zë, e godit, e kap, e arrin; *e merr ana* (një kafshë) = e ha ana, e tërheq ana, varet barra nga një vënë; *e muer ana kalin*; — *masa* (për diçka) = caktoj veprimet që duhen bërë, ujetet që duhen përdorur: *u muerën masat për mënjanirin e këtyne* dobësive; — *drejtimin e një shkolle, e mori dreqi* (diçka) = shkon keq, mbaroi; *ja — uhan* = shpaguhem: *po trimat qi janë trima prapë ia muerën uhanë* = gr. *ἐκδίκασις*; *e — fjalën prapë a*) e tërhek fjalën; b) nis të flas përsëri: *e — në shqyrtim* (një çështje) = e shqyrtoj; *e — në bisedim* (diçka) = e bisedoj; *e — në studim* = zë e studjoj; *i — krahët armikut* = i dal në shpinë, i bie anës, mbrapa; — *linë* = shpoj linë; 2. nxë: *kjo enë nuk e merr gjithë atë vaj*; *ky kosh, kjo enë nuk merr më*; *kjo shishe merr 1 litër*; *s'ka për ta -ë thesi gjithë këtë kashtë*; gjerm. *aufnehmen, fassen*; 3. *marr + emër*, shprehje toljore = folje e një rrënje me emrin: — *të ftohët* — ftohem: *nuk dal dot, se mos — ndonjë të ftohët*; — *të ngrohët* = ngrohem: *të rri pak në zjarr të — një të ngrohët*; *merr të hapët* = përhapet: *ajo ngjarje, ajo fjalë muer të hapët*; — *frikë* = frikohem; *mora frikë, më mori frika* = më kapi frika, u friksova; — *zotime* = zotohem; — *vendim* (ose: *nji vendim*) = vendos; — *pezëm* = pezmatohem; (i) — *mëni* (dikujt) = e mënij, e urrej; 4. — *valle* (ose *një valle*) = e loz; — *frymë*; *merr erë* = zë të ketë erë të keqe: *mishi paska marrë erë*; — *nji kangë* = këndo, filloj, ia nis një kënge; *merr zjarr* = ndizet: *mori zjarr shtëpia*; — *zjarr*: ndizem, inatosem; — *vrull*, — *hov*; *më merr gazi, gjumi, vaja* = më vjen për të qeshur, për të fjetur, për të qarë, më ze gjumi, vaja; *më mori kolla gjithë natën* = më zuri kolla, më ngau kolla; *më merr lemëza* = më ze lemëza; *merr çallatë* = çallohet, bëhet me çallata; *merr rrugë* (diçka) = hyn në rrugën e zgjidhjes, të përfundimit; 5. *i — flokët* (një fëmije) = ia hek, ia qeth; *merre këtu* (me brisk) *ngadalë* = rruaje; *i — mendt* (dikuj) = e hutoj: *na muerën mentë e kresë fëmijë tue luejtë e tue ba shamatë* = na hutuan, frëngj. *abasourdir*; *ikni se na muert mendt*; 6. — *në gojë* (diçka) = flas për të; *këtë e ka -ë edhe gazeta* = për këtë ka folur, ka shkruar edhe gazeta, it. riferire; — *mendt e dikujt* = shkoj pas mëndjes së tij; 7. — *mbrapa* = ndjek, ipem pas dikujt a diçkaje: *ai që merr mbrapa këtë rrugë*; *mos me marrë mbrapa atë zakon*; 8. — *rrugë* = nisem për udhëtim; — *rrugat*, — *malin*, — *malet*, — *fushat*, — *pyllin a pyjet* = iki: *njerëzia kishin -ë pyllin me kohë për t'u fshëhur*; — *syt e iki*; — *kambët në krah* = ia mbath këmbëve e iki, shkoj; *muarën përruan* = shkuan nga përroi;

mora nga luadhet = u drejtova, mora rrugën nga luadhet; **muarnë nga mali; nga pazari**; 9. *për një gj. mës ore e kemi -ë (rrugën)* = e kemi bërë për një gjysëm ore, na u desh një gjysëm ore; *do ta shoh për sa do ta -i (atë rrugë) prej këtu deri atje*; 10. **merr burrë** = martohet (për një femër); **merr grua** = martohet (për një mashkull); 11. — **vesht** = kuptoj, mësoj diçka, informohem për diçka: *a e merr vesht ç'po të thom?* = a e kupton?; *shko merr vesht njëherë se mos ketë ardhë ai* = informohu; *kjo asht si ta -ish* = si ta kuptojsh; *e ata nuk muorë asëndonjë en këso fjalësh, përse nuk mundë merrnjinë* (= merrnin vesht, kuptonin) *për sa ai flet* (Buz. Luk. XVIII, 39) = ital. *comprendere, intendere*; — **mos m'i merr për keq ato fjale; ta merr mëndja natyrisht** = vetëkuptohet; *e — me mend* = e përfytyroj, e supozoj; 12. *e — me të mirë* = e përkëdhel; *e — me të keq dikë* = e trajtoj keq; — **me sy të keq; me sy të mirë** (dikë a diçka); 13. — **vehten** = rifitoj fuqitë pas një sëmundjeje, një goditjeje, një humbjeje; **-në thue**; 14. **ia -im një herë** = a ja marrim këngës, hajde të këndojmë; **ja -im vrapit** = vrapojmë. 15. **muer pela, lopa, delja** (a ndonjë gjë e gjallë tjetër) = u mbars, gr. *ἔστυε* 16. **muer zjarri** = filloi të ndizet; **ka -ë zjarri** = është ndezur; **muer baroti** = u ndez; **muer dyfeku, pushka** = ndezi, shkrep; 17. **merr për mbarë a për keq** (diçka) = hyn në rrugën e mbarë a të keqe, zë të zhvillohet mbarë a keq: *e shikonte se ajo punë s'merrte për mbarë; merr për mbarë (koha): thëllima e dimrit të mbarë që pat -ë atë mot; po bi shi mjaft, e ka -ë si me qenë vjeshtë* = e ka zënë, e ka nisë moti si të ishte vjeshtë; 18. **gatitem të bëj diçka ose zë nis: muer me ra n'dyshek** = u bë gati të binte. . . ; *anijet muernë me kthye, por hasnë në...*; **muer e tha** = zu e tha, frgj. *se mit à dire; po ke i shohënë, marrinë me u përrallunë* = zënë të përrallen (Budi, Pasq. 256); *ishin grumbullue e merrshin me msy* = mësnyin, nisnin të mësnyin, të sulmonin; *s'e lëshoi vehten, po mori e u ngrit brof në këmbë*; 19. fm. **më mirret zëri** = më ngjiret, jam i ngjirur; **më mirren këmbët** = s'eci drejt e me hap të sigurtë; **më mirren mentë** = kam turbullirë në kokët e s'e kam ekuilibrin.

maruçkë-a ef. karanhë, mizë dheu e madhe.

marrafille mb. dhe ef.: *grue* — = e ngathët (Elb.); sh. *marranjelë*.

marrakotem 1. kotullohen, më merren sytë nga gjumi; 2. eci si përgjumshëm, it. *barcolare* 3. më merren mëntë (Lumë); edhe Gaz. 249-250 për Malësinë e Madhe të Shkodrës; FGJSH 292 *marrakot* fk. = i marr mentë; *marrakotem* = 1. eci si përgjumshëm, kalamendas; 2. kotullohem.

marramend ndf. : *a* — (= kot) *qe apo vërtet?* (Mart. i Matit).

marranjasem fm. ngathem, mezi lëviz: *iu marranjasën duart (a dejt)*.

marranjelë-a mb. dhe ef. grua e ngathët që mezi i bën punët e shtëpisë (Elb.); edhe *marrafille*; krhs. me *marranjasem*.

marre — **marrja** ef. turp: *janë zanë në — e në turp*.

martë(e) : *të marrë* = të martënë (Bellkamen i Fllorinës)

marrë (i,e) mb. emf. 1. i shkalluar; i çmendur (Jugë dhe Veri); 2. budallë, leshko; *të -in mos e pyet, se të kallzon vetë* (Veri); 3. — *mendshit* (Pj. Bogd., Shk. 1, Ligj. III, 13).

marrësonem fm. marrohem, marrosem: — *nga harea* (arbëreshët e Greqisë).

marrje — **marrja** ef.: *marrja e një vendimi, e vendimeve; marrja e masave dishiplinore*.

marrme (e)-ja ef. rruga, mëditja gr. *εἰσόδημα*, gjerm. *gehalt*.

marrohem fm.: *shoqet, kur e dëgjuan, nga mëndja u marruan; do — nga gëzimi* = do çmendem; sh. edhe FGJSH 293 *marroj* = marros, çmend, e *marrohem*.

marrshëm (i), -e (e) mb. pa inisiativë, jo i shkathët, (gjasësisht nga *marre* =

= turp,) njeri me turp, i turpshëm.

martas ndf. : *dielli kenka çue* — = i veshur me një mjegull të hollë, po i qartë e i shndritshëm; *sot qeka drita* — = e veshur; sh. edhe Gaz. 250, FGJSH 293; 2. keqas: *kallomboqi mbiu* — .

marrun (i,e) mb. : i — gjymtyrësh, i — kambësh, duersh, i — gojet = njeri që s'i punojnë gjymtyrat, këmbët, duartë, goja.

marrun (i) vesh mb. : njeri i — = që të kupton.

mas-mazi, **maz-i** em; shm -a mëzi, i vogli mashkull i pelës.

mase l dhz. : *ma se (aqë sa) fole ti që s'qe aty, aqë foli dhe ai.*

masë-a ef. : një — me dhe, — me grun, — me arra etj. = kopicë, stivë, grumbull.

masgall-i, **mazgall-i** em. dritarja e vogël me xham, e hapur në mur a në portë në disa zyra për të komunikuar me popullin, frgj. *guichet: në një bankë t'Pragës erth një grue dhe, me një fletore n'dorë, pritte tu* — i; *zotnia direktor çohet e prej* — it. i *flet grues*; krhs. me *masgallë-a*; FGJSH 295 1. frangji; 2. kamare anës vatrës.

masgallë-a **mazgallë-a** ef. vrimë e madhe: *i hapi një vrimë sa një* — ; sh. edhe *masgall-i*, *mazgall-i*.

masqafe — **masqafja** ef. *t'raftë masqafja* (nëmë), nga shprehja: *t'raftë masqafës*.

mastek-u em. *mashterk-u* (G. Hahn, Alb. Stud.)

mastë-a ef. enë ku shtihen teshat e palara (Shkod.)

mastël-i em. *masë matjeje e drithit: endënë një* — (Buz. Mat. V. 151) it. *maggio*, gr. *ὑπό τόν μόδιον* (Kristof. : *ndënë hu të drithit*).

masurë-a ef. një si gjepi, fyza; edhe *masur-i* FGJSH 293.

mashabigë-a ef. kacia.

mashallnik-u em. mblatë e drunjtë për meshë.

mashan-i em. kacia, lopata me të cilën i hedhim prushin bukës për ta pjekur (Him., Malëshovë); krahaso me *mashë*.

mashë-a ef. përdorëse shtëpiake e vatrës për të zënë thëngjijtë e ndezur; *i paske duartë* — = të ftohta, qenkan ngrirë prej të ftohtit; *është bërë si -a bigë* (VI.) = i kërmisur e i thatë.

mashë-a ef.: — *e klins* = shkop e cingël, lojë fëmijësh (Kosovë).

mashën-a ef. një si stan, po me gardh më të lartë, i mbuluar herë herë edhe me furde që vlen për të shtënë barin e thatë brenda; sin. *plemë-a*, *pleme* — *plemja*, *plevicë-a*; (Dibër) kasolle ku venë bar a kashtë për bagëtinë, magaze e madhe kashte a bari, një vend i gjerë në shtëpi, i mbuluar, ku mbahet kashtë a bar për bagëtitë; (Lumë) një farë kasollje ku shtihet bar; 2. (Shëngjergj i Tiranës) vend i ruajtur për kullosë, i bërë edhe kasolle: — at e **gjavet**. FGJSH 294: 1 stan dhensh; 2. shtëpi në vërri; 3. kulla, kasollja e sanës, e kashtës.

mashëryer (i,e) mb. *gjellë të -a* = kreshmore (Korçë); edhe *gjellë të mashnryera*, *gjellë çkërmore*; sh. edhe *mashëryer* (i,e).

mashënyer (i,e) mb. : *gjellë e* — = pa lyrë, pa bulmet; fig. *njeri i* — = i shplarë, i ftohtë, frgj. *fade*; sh. edhe (i,e) *mashëryer*, (i,e) *mashënyer*.

mashkë-a ef. tas balte, krhs. me *mashkër* dhe *mashtërkë*.

mashkër-a enë balte si sahan i madh për të shprazur në të gjellë (Kav.); krhs. me *mashkë* dhe *mashtërkë*.

mashkulli-a efk. *mashkujt*, *burrat*, *tërësia e tyre: do t'dalin jashta malit të tanë qi janë* — ; -a e *shtëpisë*; sh. edhe *mashkullim-i*; edhe FGJSH 294.

mashkullim-i emk. burrat, meshkujt e një vendi të caktuar; edhe *mashkulli-a*; sh. edhe FGJSH 294.

mashkullon fjk. pjell, lind meshkuj (si për shtazë, si për njerëz): *a të — apo të femnon gjâja?* (Lumë); Gaz. 250 për Malësi të Madhe të Shkodrës vetëm për lopë (= bën viça meshkuj); FGJSH 294 po ashtu.

mashkur-i em. kupac i vogël a i madh; krhs. *mashkë, mashkër, mashtërk.*

mashnar-i em. bariu që verës shkon me gjë prej shtëpisë së katundit (ku rri gjithnjë) në kullosë, në mashën, në verri, në stan.

mashnej fk.: *do t'i -më enët sot* = do t'i pastrojmë (thuhej të hënën e madhe kur i lanin enët) (Korçë), sh. *çkërmoj*.

mashnjehem fmp. 1.: i është *mashnjyer gjiri* = i është sëmurë gjiri dhe i është prishur qumështi (gruas, deles a ndonjë bagëtie tjetër); 2. *buka u mashnyje* = = nuk u poq mirë; 3. *toka u mashnyje* (Vlorë).

mashnjyer (i,e) mb.: *gjellë të -a* = pa bulmet, pa mish, gjellë kreshmore (Korçë); edhe: *gjellë të mashënyera, gjellë të mashëryera.*

mashqet- efs. : *ka marrë -t e nënës* = mësimet, udhëzimet e nënës.

mashtë (i,e) mb. i, e majtë: *dorë e —.*

mashtër-i em. 1. sahan i madh druri a balte; 2 kupac për të shtypur diçka (Dibër); sh. *mashkë, mashkër, mashtërk, mashtërkë, mashkur*; FGJSH 294. *mashtër — mashtra.*

mashtërkë-a ef. **mashtërk-u** em. enë si bludeja, enë druri në formë të kupës (Mird.); krhs. me *mashkë* dhe *mashkër*; *ndë një mashtërk t'ambëlë ashtë shtijm helmi* (Pj. Budi, Pasq. 141); *e pruri kriet e tij ndë mashtërk* (Gr. Argjir. Mark, VI, 28) = it. *in un bacile* ose *bacino*, gr. ἐνὶ πύλακι; sh. edhe *mashter*. FGJSH 294 *mashterk-u* = pjatë e drunjtë e thellë.

mashtëron fk. : *aj ujë nuk e — arën e vet* = nuk i mjafton, nuk i maston (Shpat i Elb.)

mashtrek-u em. enë, kupë, çanak (Budi), krhs. *mashtërk-u, mashterk-u, mashtërkë-a.*

mashtroj fk. : — *fëminë* = e koboj, e pajtoj (Lumë, Kos.); sh. FGJSH 294 me kuptimin më të përgjithshëm, më të zakonshëm të fjalës.

mat fk. : *shtatë herë mat e një herë pre* = mendoje mirë para se ta bëjsh një gjë; — **em** fm.: *eja të -emi kush âsht mâ i gjatë* = të marrim masën e shtatit, të krahasojmë madhësinë e shtatit; fig. *s'mund të -esh ti me atë* = s'mund të krahasohesh, të hahesh; **-em** *me hien e mengjezit, me hien e hanës* = mburrem me tepri, jam kryelartë zakonisht pa vend; *ai -et me hien e mëngjezit* = i duket vetja se ç'është, tregon krenari (në mëngjes, kur len dielli, hieja e njeriut që ecën duket e madhe); kam në mend të bëj një punë, jam gati për ta bërë: *u -a t'iki; po -em të* = frgj. *je suis sur le point de. . .*; **-em** për. . . : *prifem për. . ., gatitem për. . ., frgj. je suis tout prêt à . . .*

mataresë-a ef. rregullim: *kam ca -a për të bâ* = kam për të rregulluar disa gjëra; sh. FGJSH 294 *matarim-i.*

mataros fk. 1. rregulloj: **e matarova odën** = e pastrova, e rregullova; *shko se e mëshiva odën dhe e matarova*; edhe: *e tfillova*; (*Luli po mirrte e po i godiste librat*), *do gjithnjë të -ë* = të ndreqë, të rregullojë (Tir.); FGJSH 294: mbaroj, rregulloj një punë (sidomos një punë shtëpiake); mbarështoj; // **matarohem** fm.: **matarohemi me bulmet** = rregullohemi, plotësojmë nevojat; edhe: *bâhemi idare me —.*

matër-i em, shm. -ë tra (i shtëpisë) i hollë a i trashë: *je sa një — i gjatë* (Dukat

i Vlorës); edhe *matërë matri-a*; del nga ital. *mattero* = randella, grosso bastone; krhs. *matinë-a* (gegër.) = purtekë.

matekë-a ef. tra, sh. *matër-i*; edhe *matri-a*.

matinë-a ef. purtekë; krhs me *mater-i*, *materë-a*, *matri-a* FGJSH 295.

matrakë-a ef., shm. -ë çomage; krhs me *mater-i*, *materë-a*, *matri-a*; frgj. *rondin*, gros bâton (S. Kolea)

matri-a ef. tra; sh. *matër-i* (Qeparo i Himarës e gjetiu në Jugë).

matun-matur (i,e) mb. i peshuar: *njeri i — në punë, në fjalë*.

math(i) — madhe(e) mb. shih *madh(i)*, -e(e) 1. që është me shumicë: *simjet âsht bâ ulliri i — qi nuk mbahet mend kurrë* (Elb.); që e ka një vetijë në një shkallë të lartë: *âsht inatçi i —*; është shumë zemrak; 2. i rritur: *i — e i vogël s'mbeti pa vajtur*, 3. *i dha gjith të — të mirat, gjithë të-t e të miravet = tërë të mirat*; 4. ndf. *qesh me të —, me të -e* = shumë, sa mund; 5. **me një të —** = seriozisht; *unë me një të — shkova, ta marr poçin, po kur nuk e gjeta aty; u ngrita me një të —*.

mathësoj fjk. zmadhohem, bëhem më i madh: *ka shtuar e mathësuar mbretëria* (N.Fr. Gjithës. 126); shih edhe *madhoj*, *madhëroj*.

mazarohe fm. marazohem, mbushem me maraz; rezultat metateze i *marazohem*.

mazatak-u em. viç një vjeç, deri në një vit e gjysëm, *mazatuer* (Veri).

mazatuer — mazatori em. viç njëvjeçar (Lumë); edhe Gaz. 251 = *mazatore*; FGJSH 295; mb *viç —* = viç motak që pi qumësht (Shpat i Elb.); FGJSH *lopë mazatore* = lopa që ka viç.

maze-ja ef. 1. mëze, e vogla femër e pelës, sh. *maz-i*; 2. (Vërçë e Gramsh.) dele a lopë që ka gjashtë muaj që ka pjellë, sh. edhe *mazë*.

mazë-a ef. 1. lopa që ka pjellë një herë e që quhet *pllejë*; **pastaj** shkon dy vjet pa pjellë, e ka qumështin e trashë (Lumë); lopa që e ka ndarë viçin e nuk pi më, që e ka viçin tri muajsh e përpjetë, sh. Bashk. 257; mb. *lopa —* (Lumë) = =ajo që ka pjellë motit e milet ende, edhe FGJSH 295: lopa që polli vjet dhe sivjet nuk jep qumësht; dele a dhi që ka pjellë, që milet pas gjashtë muajsh, e përkundërta e shterpës, sh. edhe *mazatuer*; 2. ajka e qumështit përgjithësisht, kajmaku; shumë ajka qumështi bashkë, të trasha e bërë si djathë, e me krypë; 3. miell misri i zier me kajmak.

mazi-a ef. tokë e punuar, e kundërta e djerrit; mb. *tokë —* (kat. e Tir.); FGJSH 296: dhe i ngarë, tokë e punuar dhe e bërë gati për ta mbjellë, *ugar*.

mazi-a ef. një farë kokrre që shtypet për të nxirë flokët e gravet (Përm.), sh. edhe FGJSH 295-6.

mazis mazitë fk. i marr mazën, ajkën qumështit, *mazit*, Bashk. 257; sh. edhe FGJSH 296.

mazit fk. mazis, i marr mazën, ajkën qumështit; *tamël i mazitun* Bashk. 257, FGJSH 296 *mazis*.

mazojkë-a ef. një farë pulendre që mëlmehet me mazë, me ajkë, krhs. *ajktuer — ajktori*.

mazon fjk. : *kjo lopë —* = milet deri vonë, deri në pjellë tjetër, milet ende pas dy vjeç, megjithëse i ka shkuar koha (Lumë); khs. *mëzon*, *mazë*.

mazujkë-a ef. mëze, maz femër.

mazur mbm. *viç —* = viç motak që nuk pi qumësht (Shpat i Elb.).

mazhë-a ef. dele me lesh të bardhë dhe me të dyja faqet e zeza.

